



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 111

30 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr. 451, datë 11.7.2012	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin e asistencës teknike për zbatimin e projekteve në sektorin e rrugëve në Shqipëri.....	6467
Vendim i KM nr. 460, datë 11.7.2012	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin me grant, në kuadër të asistencës teknike të Instrumentit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor, të projektit të ujësjellësit të Durrësit.....	6475
Vendim i KM nr. 465, datë 18.7.2012	Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm.....	6485
Vendim i KM nr. 467, datë 18.7.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës.....	6485
Vendim i KM nr. 470, datë 18.7.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të ndërtimit dhe shfrytëzimit të portit të jahteve në qytetin e Durrësit dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet subjektit “I.S.D.C.”.....	6487
Vendim i KM nr. 472, datë 18.7.2012	Për shpalljen “Park kombëtar” të ekosistemit natyror mali i Tomorit, me sipërfaqe të zgjeruar.....	6487

VENDIM
Nr. 451, datë 11.7.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI), PËR FINANCIMIN E
ASISTENCËS TEKNIKE PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE NË SEKTORIN E RRUGËVE
NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin e asistencës teknike për zbatimin e projekteve në sektorin e rrugëve në Shqipëri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE
Ndhima teknike për zbatimin e projektit
Sektori i rrugëve në Shqipëri
(Asistencë teknike në kuadër të investimeve në Ballkanin Perëndimor)

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE

Luksemburg (datë)

Kjo Marrëveshje (më poshtë e quajtur “Marrëveshja”) është bërë ndërmjet:

Bankës Europiane të Investimeve me zyrat e saj qendrore në bulevardin “Konrad Adenauer” 100, Luksemburg, përfaqësuar nga z. Christopher Hurst, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Projekteve dhe z. Dominique Courbin, drejtues i divizionit, operacionet e huadhënies MA-3, më poshtë e quajtur “Banka” ose “BEI”, nga njëra anë, dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave, z. Ridvan Bode, më poshtë i quajtur “Përfituesi” nga ana tjetër (Banka dhe Përfituesi, më poshtë të quajtura “Palë” dhe së bashku “Palët”),

Duke pasur parasysh se:

1. Përfituesi ka kërkuar ndihmë financiare nga Banka, në mënyrë që Autoriteti Shqiptar i Rrugëve (ARA) të prokurojë shërbimet e një firme konsulente për të ndihmuar zbatimin e projekteve për kryerjen e investimeve të planifikuara dhe të vazhdueshme të financuara nga BEI dhe BERZH në rrjetin e rrugëve kombëtare (shërbimet e konsulencës) për projektin, siç është përkthyer në termat e referencës të përcaktuar në skedulën A të kësaj Marrëveshjeje.



2. Komiteti Drejtues i Kuadrit për Investimet në Ballkanin Perëndimor (WBIF) ka miratuar shpërndarjen e fondeve për këto shërbime konsulence dhe është rënë dakord që ato të financohen nga fondi i përbashkët evropian i vendeve të Ballkanit Perëndimor (buxheti WBIF/EWBJF) (0.25 milion euro) dhe nga buxheti i BEI-t, buxheti i WBIF/BEI (0.25 milion euro). Përfituesi dhe ARA do të sigurojnë me të gjitha mjetet që shërbimet e konsulencës mund të bashkëfinancohen me 0.25 milion euro shtesë nga buxheti i WBIF/BERZH, të cilat nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje Financimi ndërmjet Bankës dhe Përfituesit.

3. ARA do të lidhë një kontratë konsulence (kontratë konsulence) me konsulentët (konsulentin) për kryerjen e shërbimeve të konsulencës.

4. Referencat këtu për nenet, skedulet dhe anekset janë referenca përkatësisht ndaj neneve, skeduleve dhe anekseve të kësaj Marrëveshjeje.

5. Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të Palëve do të jenë siç është përcaktuar në këtë Marrëveshjeje.

Kështu pra, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Financimi i asistencës teknike

1.01 Shuma e grantit

Sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara më poshtë në këtë Marrëveshje, Banka është e gatshme të vërë në dispozicion të Përfituesit, dhe Përfituesi pranon në të njëjtën kohë, fondin (grantin) për një shumë maksimale prej 500.000 euro (pesëqind mijë euro), që do të financohet plotësisht në kuadrin e investimeve për Ballkanin Perëndimor, që do të përdoren ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të konsulencës.

Granti nuk do të përdoret për të financuar TVSH-në në shërbimet e konsulencës.

1.02 Procedurat e pagesës

Granti do t'i jepet Përfituesit, në kuadrin e investimeve për Ballkanin Perëndimor, sipas kërkesës dhe në përputhje me kushtet e nenit 1.04 (kushtet e pagesës).

Banka do të disbursojë një grant deri në 4 transhe (secili një "transh"). Shuma e transhit të parë do të jetë 250,000 euro. Shuma e çdo transhi pasues, në qoftë se nuk është balanca e patërhequr e grantit, do të jetë një minimum prej 100.000 eurosh. Herë pas here, deri në fund të kontratës së konsulencës, Përfituesi nëpërmjet ARA-s mund të paraqesë një kërkesë disbursimi te Banka, kryesisht në formën e bashkëlidhur si në skedulin B.

Çdo kërkesë disbursimi, së bashku me provat e nevojshme, sipas nenit 1.04 (kushtet e pagesës), duhet të merret nga Banka të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së caktuar për disbursimin e kërkuar nga ARA. Përfituesi pranon se pagesa e bërë për të do të përbëjë disbursimin sipas kësaj Marrëveshjeje.

Përfituesi do të jetë përgjegjës për marrjen e fondeve të disbursuara më poshtë e vënien e tyre në dispozicion për ARA-n. Ministria e Financave do të transferojë fondet e dhëna për ARA nëpërmjet një marrëveshjeje transferuese.

1.03 Monedha e pagesës

Të gjitha pagesat në lidhje me këtë Marrëveshje do të paguhën në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 2 (monedha e pagesës së zbatueshme) më poshtë:

1.04 Kushtet e pagesës

A. Disbursimi i parë në bazë të nenit 1.02 është i kushtëzuar me marrjen nga Banka, në përputhje me faturën në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, në ose para datës që bie tridhjetë (30) ditë para datës së kërkuar të disbursimit, e një kopjeje origjinale ose të vërtetuar të kontratës së konsulencës.

B. Çdo disbursim, me përjashtim të atij të parë, do të jetë më tej subjekt i pranimi të

Bankës, jo më pak se tridhjetë (30) ditë para datës së disbursimit të kërkuar, të provave dokumentare të pranueshme për Bankën, që ARA do të ketë shkaktuar shpenzime (neto të taksave) në lidhje me pjesë të shërbimeve të konsulencës që do të financohen nga Banka, nga dita e 180-të, që bie pas datës për disbursimin, të specifikuar në kërkesën e disbursimit, në një shumë të paktën të barabartë me totalin e: i) 100% të shumave të të gjitha transeve të disbursuara më parë; dhe ii) 100% të shumës së transhit që do të disbursohet.

Çdo disbursim i bërë më parë i shpenzimeve, do të jetë subjekt i marrjes nga Banka, brenda 180 ditëve nga data e disbursimit, të kopjeve të faturave të paguara nga ARA për konsulentin. Kopjet e faturave duhet të shoqërohen me një raport nga një audit i pavarur i jashtëm për këto fatura, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën. Nëse ndonjë pjesë e provave të dhëna, nuk është e pranueshme për Bankën, Banka mund të disbursojë proporcionalisht më pak se shuma e kërkuar, pa cenuar nenin 1.02.

Dëshmi dokumentare, duke përfshirë faturat, të paraqitura Bankës, për plotësimin e kushteve të parashikuara sipas këtij neni 1.04 (kushtet e pagesës), nuk do të paraqiten më shumë se një herë për disbursim.

Për pjesën e disbursimeve të financuara nga buxheti i EWBJF-së, i gjithë disbursimi kushtëzohet nga marrja nga Banka, në ose para datës që bie 15 ditë para datës së disbursimit të kërkuar, të pagesës përkatëse të bërë nga EWBJF për Bankën për këtë qëllim.

1.05 Anulimi i grantit

Banka mund të anulojë pjesën e grantit në çdo kohë pas ndodhjes së ndonjë ngjarjeje të përmendur në nenin 7 (shkelja e detyrimit).

Pjesa e padisbursuar e grantit do të konsiderohet e anuluar, nëse parapagimi është kërkuar në bazë të nenit 7 (shkelja e detyrimit).

1.06 Pezullimi i disbursimit

Pa cenuar nenet 1.05 (anulimi i grantit) dhe 7 (shkelja e detyrimit), Banka në çdo kohë mund të pezullojë dhënien e grantit pas ndodhjes së ndonjë ngjarjeje të përmendur në nenin 7 (shkelja e detyrimit). Banka mund të vazhdojë pezullimin për aq kohë sa konsideron se ngjarja vazhdon.

Neni 2

Monedha e aplikueshme e pagesës

- A. Banka do të kryejë të gjitha disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje në euro.
- B. Çdo shumë do të paguhet nga përfituesi për Bankën, sipas kësaj Marrëveshjeje në euro.
- C. Një deklaratë me shkrim nga Banka për shumën e përgjithshme që duhet të shlyhet nga Përfituesi, përveç rastit të një gabimi flagrant, është dëshmi bindëse e shumës së kërkueshme.

Neni 3

Pagesat

3.01 Pagesat për Përfituesin

Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Financave, do të hapë një llogari të posaçme për pagesën e grantit (llogaria). Banka do të bëjë çdo disbursim në llogarinë, të dhënat e së cilës do të jepen nga ARA në kërkesën e disbursimit. Llogaria do të përdoret në çdo kohë dhe në të gjitha rastet, ekskluzivisht për qëllimet e grantit.



Neni 4 Ndërmarrjet e veçanta

4.01 Përdorimi i të ardhurave nga granti

Përfituesi merr përsipër që ai dhe ARA do të përdorin të ardhurat e grantit vetëm për financimin e shërbimeve të konsulencës të përshkruara në termat e referencës.

4.02 Kontrata me konsulentin

Përfituesi siguron që ARA do të ndërmarrë, të mos anulojë, ndryshojë ose pezullojë kontratën e konsulencës, pa marrëveshje paraprake me shkrim të Bankës.

4.03 Rritja e kostove të shërbimeve

Nëse ndodh që kostoja e kryerjes së shërbimeve të konsulencës të tejkalojë buxhetin fillestar të përcaktuar në kontratat e konsulencës, ARA do të informojë menjëherë Përfituesin dhe Përfituesi do të marrë financat për të financuar kostot e tepërta pa iu drejtuar Bankës, në mënyrë që të realizojë shërbimet e konsulencës në përputhje me përshkrimin teknik. Në këtë rast, Përfituesi do t'i paraqesë Bankës për konsultim paraprak në kohën e duhur parashikimin për këto financime shtesë.

4.04 Kryerja e shërbimeve

Përfituesi, përmes ARA-s, do të sigurojë që shërbimet e konsulencës, të mund të ripërcaktohen herë pas here me miratimin e Bankës, të kryhen dhe të përfundohen brenda afatit të parashikuar në kontratën e konsulencës apo ndonjë kohë tjetër, sipas aprovimit të Bankës.

4.05 Përzgjedhja e konsulentit

Është pranuar se:

A. ARA ka marrë një aprovim nga Banka për procedurën e prokurimit të zgjedhur dhe përzgjedhjen përfundimtare të konsulentit; dhe

B. Ministria e ka lexuar dhe pajtohet me objektin e shërbimeve të konsulencës.

4.06 Detyrimet e bashkëpunimit

Përfituesi siguron që ARA do të kujdeset për të siguruar që punonjësit e saj përkatës të bashkëpunojnë në çdo kohë me Bankën dhe konsulentin në lidhje me ofrimin e shërbimeve të konsulencës.

4.07 Ndihma me anë të rregulloreve lokale

Konsulenti mund të kërkojë ndihmën e Përfituesit ose të ARA-s në marrjen e kopjeve të ligjeve vendore, rregulloreve dhe informacioneve, të cilat mund të ndikojnë në kryerjen e detyrimeve të tij sipas kontratës së konsulencës.

Në bazë të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën e të huajve në Shqipëri, Përfituesi dhe ARA do të bëjnë përpjekje maksimale për të siguruar që konsulenti dhe punonjësit e tij të marrin vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejet e punës dhe të qëndrimit, kur është e zbatueshme.

4.08 Angazhimi ndaj integritetit

Përfituesi garanton dhe merr përsipër se as ai, as ARA dhe asnjë person, sipas njohurive të tij të tashme, nuk ka kryer ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe se ai dhe ARA, dhe asnjë person, me pëlqimin e tyre ose me dijeni paraprake, nuk do të kryejnë ndonjë veprim të tillë, që do të thotë:

i) ofrimi, dhënia, marrja apo kërkimi i ndonjë avantazhi të padrejtë për të ndikuar në veprimin e ndonjë personi që mban një post ose funksion publik, ose një drejtor apo punonjës i një autoriteti publik ose ndërmarrje publike apo një drejtor ose zyrtar i një organizate publike ndërkombëtare në lidhje me ndonjë proces prokurimi ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate në lidhje me ato elemente të shërbimeve të konsulencës, të përshkruara në termat e referencës; ose

ii) çdo veprim që ndikon apo synon në mënyrë të paligjshme të ndikojë në procesin e prokurimit ose zbatimin e shërbimeve të konsulencës në dëm të ARA-s, duke përfshirë marrëveshjen e fshehtë ndërmjet tenderuesve.

Përfituesi merr përsipër të informojë Bankën nëse ai ose ARA duhet të vihen në dijeni për çdo fakt ose informacion për kryerjen e ndonjë veprimi të tillë dhe do të lehtësojë çdo hetim që

Banka mund të bëjë në lidhje me këtë veprim ose sjellje.

4.09 Vlefshmëria e shërbimeve të konsulencës

Përfituesi bie dakord pas zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, për të lejuar çdo person, duke përfshirë, por pa u kufizuar te konsulentët e jashtëm, të emëruar herë pas here nga Banka, për të kryer vlerësimin e aspekteve të caktuara të shërbimeve të konsulencës të kryera nga konsulenti.

Neni 5

Monitorimi dhe aprovimi i raporteve

5.01 Në lidhje me shërbimet

Përfituesi siguron që ARA do të ndërmarrë:

a) për t'i komunikuar me shkrim Bankës ndonjë koment që mund të ketë mbi rezultatet e shërbimeve të konsulencës;

b) për të këshilluar menjëherë Bankën për çdo fakt apo ngjarje të njohur për ARA-n, të tillë që mund të cenojë ose ndikojë në përmbushjen e shërbimeve të konsulencës;

c) për të ndjekur zbatimin e shërbimeve të konsulencës, të miratuar të gjitha raportet (siç referohet në përshkrimin teknik në skedulën A), pasi të ketë marrë miratimin me shkrim të Bankës në versionin përfundimtar të këtyre raporteve. Një kopje e këtyre raporteve përfundimtare do t'i dërgohet Bankës dhe do t'i sigurojë Bankës një raport tremujor mbi ecurinë e shërbimeve të konsulencës;

d) për të bërë përpjekje të arsyeshme për të marrë leje për çdo përfaqësues të autorizuar të Bankës për të komunikuar me të dhe nëse është e nevojshme, për të vizituar konsulentin, në mënyrë që të marrin informacione, siç Banka mund të kërkojë, në lidhje me ecurinë e shërbimeve të konsulencës; si dhe

e) për të komunikuar një raport të pranueshëm për bankën brenda 2 muajve pas përfundimit të shërbimeve të konsulencës.

Raportet specifike për zbatimin e shërbimeve të përgatitura nga ARA, dhe/ose ato të përgatitura nga konsulentët, të financuara me të ardhurat e grantit, duhet të përmbajnë paralajmërimin si më poshtë:

“Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët të Europës Perëndimore në kuadër të investimeve për Ballkanin Perëndimor. Pikëpamjet e shprehura këtu janë ato të (emri i autorit) dhe prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohen sikur pasqyrojnë mendimin zyrtar të kontribuesve për Fondin e Përbashkët Europian për Ballkanin Perëndimor ose BEI apo BERZH, si bashkëdrejtues të Fondit Europian të përbashkët të Ballkanit Perëndimor.”

5.02 Në lidhje me Përfituesin dhe ARA-n:

a) Përfituesi përgjithësisht do të informojë Bankën për çdo fakt apo ngjarje që mund të pengojë përmbushjen e ndonjë detyrimi si më poshtë nga Përfituesi ose ARA; dhe

b) Përfituesi siguron që ARA do të marrë përsipër t'i paraqesë Bankës çdo dokument të kërkuar nga kjo e fundit, duke përfshirë, por pa u kufizuar te raportet e auditimit apo pasqyrat e kontabilitetit.

5.03 Vizitat

Përfituesi pranon se Banka mund të jetë e detyruar të publikojë këto dokumente në lidhje me ARA-n dhe konsulentin në Gjykatën e Llogarive të Komuniteteve Europiane (më poshtë e quajtur “Gjykata”), që janë të nevojshme për kryerjen e detyrës së Gjykatës në përputhje me ligjin e Komunitetit Europian.

Përfituesi siguron që ARA t'u lejojë personave të caktuar nga Banka, të cilët mund të jenë të shoqëruar nga përfaqësues të Gjykatës, për të vizituar ARA-n, konsulentin dhe për të kryer kontrolle, siç mund të dëshirojnë. Për këtë qëllim, Përfituesi dhe ARA do t'u japin atyre të gjithë ndihmën e nevojshme. Në rastin e një vizite të tillë, përfaqësuesit e Gjykatës mund t'i kërkojnë



përfituesit dhe/ose ARA-s që të vënë në dispozicion të tyre dokumentet në zbatim të qëllimit të paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 6 Pagesat

6.01 Tatimet, taksat dhe tarifat

Përfituesi duhet të paguajë të gjitha taksat, detyrimet ose pagesat e çfarëdo natyre, duke përfshirë detyrat për pullën dhe tarifat e regjistrimit, të cilat rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe dokumentet që lidhen me to, në përputhje me ligjet e zbatueshme të vendit. Në rast të shlyerjes së grantit ose një pjese të tij në përputhje me nenin 7, të gjitha shumat e pagueshme nga Përfituesi për Bankën do të paguhet pa zbritje të ndonjë tatimi.

6.02 Tarifa të tjera

ARA do të përballojë tarifat e saj profesionale dhe bankare dhe çdo pagesë transferimi apo shkëmbimi të lindur nga ekzekutimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe kontratës së konsulencës.

Neni 7 Shkelja e detyrimit

7.01 E drejta për të kërkuar shlyerje

Përfituesi do të shlyejë menjëherë grantin pas kërkesës së bërë nga Banka në ndonjë nga rrethanat e mëposhtme:

a) Në qoftë se Përfituesi ose ARA nuk përmbushin ndonjë detyrim të tyre brenda një kohe të caktuar në mënyrë të arsyeshme në një njoftim të bërë nga Banka për përfituesin ose ARA-n që duhet të përmbushet;

b) Nëse ndonjë informacion i dhënë Bankës nga ose në emër të Përfituesit ose ARA-s në lidhje me negocimin e kësaj Marrëveshjeje rezulton të jetë i gabuar në ndonjë aspekt të veçantë material;

c) Nëse banka çmon se Përfituesi ose ARA ka vepruar në përmbushjen e detyrimeve të tyre me neglizhencë flagrante, mashtrim, shpërdorim të detyrës apo sjellje të papërshtatshme të qëllimshme;

d) Nëse Banka pezullon apo anulon një hua ose nëse Banka ka kërkuar shlyerjen e një huaje të dhënë nga Banka për Përfituesin, ose nëse një kontratë financimi e lidhur ndërmjet Bankës dhe Përfituesit është deklaruar e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një gjykatë kompetente;

e) Nëse Përfituesi ose ARA nuk kryen pagimin e përpiktë të çdo shume për Bankën sipas çfarëdo marrëveshjeje tjetër përveç kësaj marrëveshjeje;

f) Nëse ndonjë fakt i deklaruar në prezantim ndryshon ose pushon së ekzistuari dhe nëse interesat e Bankës janë cenuar prej tij në këtë mënyrë.

7.02 Të drejtat e tjera sipas ligjit

Neni 7.01 nuk përcakton ndonjë të drejtë tjetër të Bankës për të kërkuar shlyerjen e grantit.

Neni 8 Detyrimet e palëve

Përfituesi do të dëmshpërblejë Bankën nga të gjitha dëmtimet, humbjet, kostot dhe shpenzimet e pësuar apo të shkaktuara nga Banka, ndër të tjera, si rezultat i ndonjë veprimi apo mosveprimi të kryer nga ai vetë ose ARA, nga mospërmbushja nga ana e tij apo e ARA-s e detyrimeve të tyre përkatëse, të përcaktuara në këtë Marrëveshje, nga neglizhenca flagrante, për çdo akt të shpërdorimit të detyrës me paramendim dhe për çdo veprim mashtrues.

Banka nuk do të jetë përgjegjëse ndaj përfituesit ose ARA-s për ndonjë veprim apo mesveprim të konsulentëve ose për dështimin e konsulentit për të ofruar shërbime konsulence në

pajtim me kontratën e konsulencës. Megjithatë Përfituesi ose ARA mund t'i kërkojë Bankës të ndryshojë konsulentin, nëse performanca e tij, sipas mendimit të Përfituesit ose ARA-s, rezulton të jetë e pakënaqshme ose nëse konsulenti do të kryejë çdo veprim ose mosveprim të padëshirueshëm.

Banka do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të përmbushur të gjitha kërkesat nga ana e Bankës sipas kontratës së konsulencës.

Përfituesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Bankës, konsulentit ose ndaj palëve të treta për asnjë veprim apo mosveprim të konsulentit ose për dështimin nga ana e konsulentit për të ofruar shërbime konsulente në pajtim me kontratën e konsulencës.

Neni 9 **Konfidencialiteti**

Banka do të trajtojë çdo informacion të siguruar për të nga Përfituesi ose ARA, sipas detyrimeve të mëposhtme, në përputhje me rregullat normale të konfidencialitetit.

Neni 10 **Ligji dhe juridiksioni**

10.01 Ligji

Kjo Marrëveshje dhe formimi, ndërtimi dhe vlefshmëria e saj rregullohen nga ligjet e Luksemburgut.

10.02 Juridiksioni

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me këtë Marrëveshje do të paraqiten në juridiksionin e Gjykatës së Luksemburgut dhe palët në mënyrë të parevokueshme do t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Luksemburgut.

Në këtë mënyrë, palët e kësaj Marrëveshjeje heqin dorë nga çdo imunitet ose nga e drejta për të kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës së Luksemburgut.

Vendimi i Gjykatës së Luksemburgut, i dhënë sipas këtij neni, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët pa kufizim apo rezervë.

10.03 Mosheqja dorë

Asnjë mospërmbushje apo vonesë nga Banka në ushtrimin e të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë.

Neni 11 **Dispozitat përfundimtare**

11.01 Njoftime

Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna më poshtë (të ndryshme nga ato që lindin gjatë procesit gjyqësor) ndaj Bankës ose Ministrisë do të dërgohen me faks, telegram, letër rekomande ose letër me adresë të regjistruar, drejtuar atij në adresën e përcaktuar më poshtë, ose në adresa të tjera që do të ketë njoftuar më parë me shkrim si adresë e saj e re për këtë qëllim.

Për Bankën: Banka Europiane e Investimeve

Operacionet e huadhënies MA-3/Drejtoria e Projekteve

100, bulevard "Konrad Adenauer" L-2950 Luxembourg

Për Ministrinë:

Ministri i Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4

Tiranë, Shqipëri

Faks: +355 4 222 8494

Kopje për: Autoriteti Shqiptar i Rrugëve (ARA)



Z. Ylli Gjoni, Drejtor
Rruga "Sami Frashëri", nr. 33
Tiranë, Shqipëri
Faks: + 355 4 223 600
11.02 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përmbushjes së procedurave të brendshme ligjore nga Përfituesi dhe pas njoftimit të tij për Bankën.

11.03 Anekset, skedulet dhe prezantimet

Prezantimet dhe skedulet janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje:

Skeduli A: Termat e referencës

Skeduli B: Kërkesa për disbursim

Në dëshmi të kësaj, palët kanë mundësuar ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje në emër të tyre në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Nënshkruar për dhe në emër të:
BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE
Z. Christopher Hurst
Drejtori i Përgjithshëm
Z. Dominique Courbin
Drejtues i Divizionit

Nënshkruar për dhe në emër të:
MINISTRISË SË FINANCAVE TË
SHQIPËRISË
Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave

SKEDULI A TERMAT E REFERENCËS

1. Objektivat e përgjithshëm:

a) Ofron këshilla të ekspertëve dhe asistencë për zbatimin e projektit dhe menaxhimin e kontratave të lidhura me investime dhe projekte të ndërtimit të rrugëve;

b) Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme në punë të menaxherëve të projekteve në PIU, të ngarkuar me zbatimin e projektit;

c) Ndihmon në përgatitjen e projekteve të ardhshme të investimeve rrugore.

2. Struktura e pagesës

Konsulenti do të paguhet sipas një kontrate të bazuar në kohë (forma standarde e Bankës Botërore për detyrat e vogla) me buxhetin e caktuar në 500.000 euro për një periudhë prej 24 muajsh. Detyra mund të zgjatet pas konfirmimit nga BEI para përfundimit të periudhës.

Kostoja e auditit, siç parashikohet në nenin 1.04, është një shpenzim i pranueshëm sipas grantit.

SHTOJCA B KËRKESA PËR DISBURSIM

Ju lutem vazhdoni me pagesën e mëposhtme:

Data:

Marrëveshje financimi

Emri: Ndihma teknike për zbatimin e projektit - sektori i rrugëve në Shqipëri, grant për ndihmë teknike sipas kuadrit të investimeve në Ballkanin Perëndimor

Marrëveshja e financimit

Data e nënshkrimit

Burimi i financimit

Buxheti WBIF/BEI dhe buxheti WBIF/EWBJF

Numri FI i Marrëveshjes (nëse është e zbatueshme):

Shuma e kërkuar në euro:

Euro Shuma

Data e propozuar e disbursimit:

Rezervuar për BEI-n	buxheti WBIF/BEI	buxheti WBIF/EWBJF
	Euro	Euro
Shuma totale e grantit:	250 000	250 000

Paguar deri tani:

Bilanci për pagesën:

Pagesa aktuale:

Bilanci pas pagesës:

Llogaria bankare e Përfituesit që do të kreditohet:

Llogaria nr.....

(ju lutem, siguroni formatin e IBAN-it)

Kodi BIC N°

Emri dhe adresa e bankës:

Ju lutem transmetoni informacionin përkatës për:

Emri (at) dhe nënshkrimi (et) i/e autorizuar të Përfituesit

VENDIM

Nr. 460, datë 11.7.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI), PËR FINANCIMIN ME GRANT, NË KUADËR TË ASISTENCËS TEKNIKE TË INSTRUMENTIT TË INVESTIMEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR, TË PROJEKTIT TË UJËSJELLËSIT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin me grant, në kuadër të asistencës teknike të Instrumentit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor, të projektit të ujësjellësit të Durrësit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE
ASISTENCË TEKNIKE PËR PROJEKTIN E UJËSJELLËSIT TË DURRËSIT
(ASISTENCË TEKNIKE SIPAS KUADRIT PËR INVESTIME NË BALLKANIN PERËNDIMOR)
WB-ALB-ENV-06
SERAPIS 20100374

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE
[vendi], [data]

Kjo Marrëveshje (referuar në vijim si “Marrëveshja”) lidhet ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve, me zyrë qendrore në adresën: 100 boulevard “Konrad Adenauer”, Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg, përfaqësuar nga z. Christopher Hurst, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Projekteve dhe z. Dominique Courbin, shefi i seksionit, operacionet e huadhënies MA-3, referuar në vijim si “Banka” ose “EIB”, të palës së parë, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave, zoti Ridvan Bode, referuar në vijim si “Pala Përfituese”, të palës së dytë (Banka dhe Pala Përfituese referohen gjithashtu në vijim si “Pala” dhe së bashku “Palët”).

Ndërsa:

1. Pala përfituese i ka kërkuar Bankës asistencë teknike me qëllim që Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (GDWSS) të sigurojë shërbimet e firmave konsulente për të asistuar njësinë zbatuese të projektit të Ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizimeve të Durrësit (WSUCMD), agjencia zbatuese, në përgatitjen e investimeve në sistemin e ujësjellës-kanalizimeve në qytetin dhe në rajonin e Durrësit, që do të financohet nga EIB (shërbimet konsulente), siç përshkruhet veçanërisht në Përshkrimin teknik të përcaktuar në tabelën A në këtë Marrëveshje.

2. Komiteti Drejtues i Kuadrit për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF) ka miratuar alokimin e Fondeve për Shërbimet Konsulente dhe është rënë dakord që ato të financohen nga buxheti i fondit të përbashkët evropian për Ballkanin Perëndimor “WBIF/EWBJF” (475.000 euro) dhe nga buxheti i EIB “Buxheti WBIF/EIB” (475.000 euro).

3. Nëpërmjet WSUCMD, GDWSS do të lidhë kontrata shërbimi konsulente (kontratë shërbimi konsulente) me konsulentët (konsulentët) për të kryer shërbimet e konsulencës.

4. Referencat në këtë Marrëveshje të neneve, deklarimeve, grafikëve dhe anekseve janë referenca respektivisht të neneve dhe deklarimeve, grafikëve dhe anekseve të kësaj marrëveshjeje.

5. Të drejtat dhe detyrimet reciproke të Palëve do të përcaktohen në këtë Marrëveshje.

Tashmë, si rrjedhojë, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Financimi i asistencës teknike

1.01 Shuma e grantit

Sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në vijim në këtë Marrëveshje, Banka është e gatshme të vendosë në dispozicion të Palës Përfituese dhe Pala Përfituese të pranojë fondet (grantin) në shumën maksimale prej 950.000 euro (nëntë qind e pesëdhjetë mijë euro), që do të financohet plotësisht nga kuadri për investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF) për t’u përdorur ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të konsulencës.

Granti nuk do të përdoret për të financuar TVSH-në e shërbimeve të konsulencës.

1.02 Procedurat për kryerjen e pagesave

Granti do t'i disbursohet Palës Përfituese nga kuadri për investime në Ballkanin Perëndimor, me kërkesë dhe në varësi të kushteve të nenit 1.04 (kushtet për kryerjen e pagesave).

Banka do t'i disbursojë Palës Përfituese deri në 4 transhe (secila një "transh"). Shuma e transhit të parë do të jetë 250.000 euro. Shuma e secilit transh vijues, në rast se nuk është shuma e patërhequr e grantit, do të jetë minimalisht 100.000 euro. Herë pas here deri në fund të kontratave të konsulencës, Pala Përfituese, nëpërmjet GDWSS mund t'i paraqesë Bankës një kërkesë për rimbursim (kërkesa për rimbursim), kryesisht në formën bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje si tabela B.

Secila kërkesë për disbursim, së bashku me të dhënat e kërkuara sipas nenit 1.04 (kushtet për kryerjen e pagesës) duhet të merren nga Banka të paktën tridhjetë (30) ditë para datës për kryerjen e disbursimit.

Pala Përfituese duhet që të vendosë në dispozicion të GDWSS-së fondet e disburuara si më poshtë. Me anë të një Marrëveshjeje transferimi, Pala Përfituese do t'i transferojë GDWSS-së fondet e disburuara, nëpërmjet Ministrisë së Financave.

1.03 Monedha për kryerjen e pagesave

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen lidhur me këtë Marrëveshje do të bëhen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 2 (monedha e aplikueshme për kryerjen e pagesave) si në vijim.

1.04 Kushtet e kryerjes së pagesave

A. Në zbatim të nenit 1.02, disbursimi i parë do të kryhet në varësi të marrjes nga Banka, në formën dhe përmbajtjen që kënaq kërkesat e saj, në ose para datës që përkon me tridhjetë (30) ditë para datës së kërkuar për rimbursim, të origjinaleve/kopjeve të vërtetuara të kontratave të konsulencës të ekzekutuara, për një shumë që arrin në total të paktën sa shuma e disbursimit të parë të planifikuar.

B. Çdo disbursim, me përjashtim të së parës, do të jetë më tej subjekt i marrjes nga Banka, jo më pak se tridhjetë (30) ditë para datës së kërkuar për disbursim, të provave me dokumente që kënaqin kërkesat e Bankës, ku GDWSS të ketë përfshirë shpenzimet (shpenzimet neto të taksave) në lidhje me pjesën e shërbimeve të konsulencës që do të financohen nga Banka, ditën e 180-të pas datës për disbursim, të specifikuar në kërkesën për rimbursim, në një shumë të paktën të barabartë me shumën totale të: (i) 100% të shumave të të gjitha transheve të disburuara më parë; dhe (ii) 100% të shumës së transheve që do të disbursohet.

Disbursimet e shpenzimeve të bëra paraprakisht do të jenë subjekt të marrjes nga Banka brenda 180 ditëve nga data e disbursimit, të kopjeve të faturave që GDWSS i ka paguar konsulentit. Kopjet e faturave do të shoqërohen me një raport që do të përgatitet nga një auditues i jashtëm dhe i pavarur për këto fatura, në formën dhe përmbajtjen që kënaq kërkesat e Bankës. Nëse ndonjë pjesë e provave të dhëna nuk kënaq kërkesat e Bankës, atëherë Banka mund të disbursojë në mënyrë proporcionale më pak sesa shuma e kërkuar, pa prekur nenin 1.02.

Provat me dokumente, duke përfshirë fatura, që i dorëzohen Bankës për përmbushjen e kushteve të parashikuara sipas nenit 1.04 (kushtet për kryerjen e pagesave), nuk do të paraqiten për disbursim më shumë sesa një herë.

Për pjesën e disbursimeve të financuara nga buxheti i EWBJF, i gjithë disburimi kushtëzohet nga marrja nga ana e Bankës, në datën ose para datës që përkon me 15 ditë para datës së kërkuar për disbursimin, të pagesave përkatëse të bëra nga EWBJF për Bankën për këtë qëllim.

1.05 Anulimi i grantit

Në rast se ndodh ndonjë nga ngjarjet e përmendura në nenin 7 (shkelja e detyrimit), Banka mund që në çdo kohë të anulojë pjesën e padisburuar të grantit.

Pjesa e padisburuar e grantit do të konsiderohet e anuluar në rast se shlyerja kërkohet sipas nenit 7 (shkelja e detyrimit).

1.06 Pezullimi për kryerjen e disbursimit

Pa prekur nenin 1.05 (anulimi për dhënien e grantit) dhe 7 (shkelja e detyrimit), Banka



mund që në çdo kohë të pezullojë disbursimin e grantit në rast se ndodh ndonjë prej ngjarjeve të përmendura në nenin 7 (shkelja e detyrimit). Banka mund të vazhdojë pezullimin për aq kohë sa ajo gjykon se ngjarja vazhdon të ndodhë.

Neni 2

Monedha e aplikueshme për kryerjen e pagesave

- a) Banka do të kryejë të gjitha disbursimet, sipas kësaj Marrëveshjeje, në euro.
- b) Çdo shumë që do t'i paguhet Bankës nga Pala Përfituese, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë në euro.
- c) Përveç rasteve të një gabimi të dukshëm, një deklaratë e nënshkruar nga Banka në lidhje me shumën totale, që duhet të shlyhet nga Pala Përfituese do të shërbejë si një evidencë e mjaftueshme për shumën e detyruar.

Neni 3

Kryerja e pagesave

3.01 Pagesat për palën përfituese

Nëpërmjet Ministrisë së Financave, Pala Përfituese do të hapë një llogari bankare të veçantë për shlyerjen e grantit (llogaria). Banka do të kryejë çdo disbursim në llogari, detajet e së cilës do të përcaktohen nga GDWSS në kërkesën për disbursim. Llogaria do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e grantit, në çdo kohë dhe në të gjitha aspektet.

Neni 4

Sipërmarrje të veçanta

4.01 Përdorimi i të ardhurave nga granti

Pala Përfituese merr përsipër që ajo dhe GDWSS do të përdorin të ardhurat nga granti vetëm për financimin e shërbimeve të konsulencës, të përshkruara në përshkrimin teknik.

4.02 Kontrata me konsulentin

Pala Përfituese garanton që GDWSS nuk do të anulojë, ndryshojë apo pezullojë kontratat e shërbimit të konsulencës pa marrë më parë miratimin me shkrim nga Banka.

4.03 Kostot e shtuara të shërbimeve

Në rast se kostot për realizimin e shërbimeve të konsulencës e tejkalojnë buxhetin origjinal të treguar në kontratat e shërbimit të konsulencës, atëherë GDWSS do të njoftojë menjëherë Palën Përfituese me shkrim dhe Pala Përfituese do të marrë financim për t'i përdorur për kostot e tejkaluara pa i kërkuar Bankës ndihmë, me qëllim për të përfunduar shërbimet e konsulencës në përputhje me përshkrimin teknik. Në një rast të tillë, Pala Përfituese do t'i dorëzojë Bankës për konsultim paraprak dhe në kohë parashikimin për kryerjen e një financimi të tillë shtesë.

4.04 Zbatimi i shërbimeve

Pala përfituese do të garantojë nëpërmjet GDWSS-së që shërbimet e konsulencës, siç mund të ripërcaktohen herë pas here me miratimin e Bankës, të kryhen dhe të përfundohen brenda periudhës kohore, të parashikuar në kontratat e konsulencës ose në ndonjë periudhë tjetër kohore, siç mund ta miratojë Banka.

4.05 Përzgjedhja e konsulentit

Pranohet se:

- a) GDWSS ka marrë nga Banka një miratim për procedurën e zgjedhur të prokurimit dhe të përzgjedhjes përfundimtare të konsulentëve; dhe
- b) Pala Përfituese, nëpërmjet Ministrisë së Financave, ka lexuar dhe ka rënë dakord me

objektin e shërbimeve konsulente.

4.06 Detyrimet për bashkëpunimin

Pala Përfituese garanton që GDWSS do të sigurojë që punonjësit e vet të bashkëpunojnë në çdo kohë me Bankën dhe me konsulentët, lidhur me dhënien e shërbimeve të konsulencës.

4.07 Asistencë me rregulloret e brendshme

Konsulentët mund të kërkojnë ndihmën e Palës Përfituese ose të GDWSS-së në marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informacionin e brendshëm, që mund të ndikojë te konsulentët në kryerjen e detyrimeve të tyre, sipas kontratave të shërbimeve të konsulencës.

Në varësi të ligjeve dhe të rregulloreve mbi punësimin e huaj në Shqipëri, pala përfituese dhe GDWSS do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të garantuar që në rast se aplikohet, punonjësit e konsulentëve dhe personat në ngarkim të tyre të marrin vizat dhe lejet e kërkuara, duke përfshirë lejet e punës dhe të banimit.

4.08 Angazhimi për integritetin

Pala Përfituese garanton dhe merr përsipër se as ajo dhe as GDWSS dhe me dijeninë e Palës Përfituese asnjë person tjetër nuk ka kryer ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe se as ajo dhe as GDWSS, si dhe asnjë person, me miratimin ose dijeninë e tyre paraprake, nuk do të kryejnë ndonjë veprim të tillë, që nënkupton:

i) ofrimin, dhënien, marrjen ose nxitjen e ndonjë avantazhi të papërshtatshëm për të ndikuar në veprimet e ndonjë personi që mban një zyrë ose funksion publik, ose një drejtor ose punonjës të një autoriteti publik ose të një kompanie publike, ose një drejtor ose zyrtar në një organizatë publike ndërkombëtare, në lidhje me ndonjë proces prokurimi, ose në zbatimin e ndonjë kontrate lidhur me ato elemente të shërbimeve të konsulencës, të përshkuara në përshkrimin publik; ose

ii) ndonjë veprim që ndikon në mënyrë të gabuar ose që ka qëllim të gabuar për të ndikuar në procesin e prokurimit ose në zbatimin e shërbimeve të konsulencës për dëmtimet që i shkaktohen GDWSS, duke përfshirë marrëveshjen e fshehtë ndërmjet tenderuesve.

Pala Përfituese merr përsipër të informojë Bankën nëse ajo ose GDWSS duhet të informohen mbi ndonjë fakt ose informacion tregues për kryerjen e një veprimi të tillë dhe do të lehtësojë çdo hetim që Banka mund të bëjë mbi një veprim ose sjellje të tillë.

4.09 Vlefshmëria e shërbimeve të konsulencës

Pala Përfituese bie dakord, me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të lejojë çdo person, duke përfshirë, por pa kufizuar konsulentë të jashtëm që emërohen herë pas here nga Banka, për të kryer vlefshmërinë mbi aspekte të caktuara të shërbimeve të konsulencës të kryera nga konsulentët.

Neni 5

Monitorimi dhe aprovimi i raporteve

5.01 Në lidhje me shërbimet

Pala Përfituese garanton që GDWSS do të marrë përsipër:

a) t'i komunikojë me shkrim Bankës për çdo koment që mund të ketë mbi rezultatet e shërbimeve të konsulencës;

b) të njoftojë menjëherë Bankën mbi ndonjë fakt ose ngjarje që GDWSS është në dijeni dhe që mund të prekin ose ndikojnë thelbësisht në realizimin e shërbimeve të konsulencës;

c) të ndjekë zbatimin e shërbimeve të konsulencës, të aprovojë të gjitha raportet (siç referohen në përshkrimin teknik në tabelën A), pasi të ketë marrë me shkrim miratimin e Bankës mbi versionin përfundimtar të këtyre raporteve. Një kopje të këtyre raporteve përfundimtare do t'i dërgohen Bankës, si dhe do t'i jepet asaj një raport tremujor mbi ecurinë e shërbimeve të konsulencës;

d) të bëjë përpjekjet e saj të arsyeshme për të garantuar leje për çdo përfaqësues të autorizuar të Bankës që të komunikojë me të dhe, në rast se është e nevojshme, të vizitojë



konsulentët me qëllim për të marrë të gjithë këtë informacion që mund të kërkojë Banka lidhur me ecurinë e shërbimeve të konsulencës; dhe

e) të komunikojë një raport të përfunduar, që kënaq kërkesat e Bankës, brenda 2 muajve nga mbarimi i shërbimeve të konsulencës.

Raportet e veçanta mbi zbatimin e shërbimeve të konsulencës, të përgatitura nga GDWSS dhe/ose ato raporte të përgatitura nga konsulentët dhe të financuara me të ardhurat e grantit, duhet të përfshijnë paralajmërimin si vijon: “Ky dokument është përgatitur me asistencën teknike të Fondit të Përbashkët European për Ballkanin Perëndimor nën kuadrin për investime të Ballkanit Perëndimor. Këndvështrimet e shprehura në këtë dokument janë ato të (emri i autorit) dhe si rrjedhojë në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se këto këndvështrime reflektojnë opinionin zyrtar të kontribuesve të Fondit të Përbashkët European për Ballkanin Perëndimor ose EIB, ose EBRD, si bashkëdrejtues të Fondit të Përbashkët European për Ballkanin Perëndimor”.

5.02 Lidhur me Palën Përfituese dhe GDWSS

a) Pala përfituese do të njoftojë përgjithësisht Bankën mbi ndonjë fakt ose ngjarje që mund të shmanjë përmbushjen e ndonjë detyrimi të Palës Përfituese ose GDWSS në këtë Marrëveshje; dhe

b) Pala Përfituese siguron që GDWSS do të marrë përsipër t’i dorëzojë Bankës çdo dokument që kërkohet nga ky i fundit, duke përfshirë, por pa kufizuar raportet e auditimit ose pasqyrat e kontabilitetit.

5.03 Vizitat

Pala Përfituese pranon se Banka mund të jetë e detyruar të publikojë këto dokumente, që kanë lidhje me GDWSS-në dhe konsulentët, te Gjykata Europiane e Llogarive (në vijim referuar si “Gjykata”), duke qenë se janë të nevojshme për kryerjen e detyrës së Gjykatës në përputhje me legjislacionin e Komunitetit European.

Pala Përfituese garanton që GDWSS do të lejojë personat e caktuar nga Banka, të cilët mund të jenë të shoqëruar nga përfaqësues të Gjykatës, të vizitojnë GDWSS-në, konsulentët dhe të kryejnë këto kontrolle sipas dëshirës së tyre. Për këtë qëllim, Pala Përfituese dhe GDWSS do t’u japin ose do të garantojnë që do t’u jepet e gjithë asistencë teknike. Me rastin e kryerjes së një vizite të tillë, përfaqësuesit e Gjykatës mund t’i kërkojnë Palës Përfituese dhe/ose GDWSS-së t’i sigurojnë dokumente që plotësojnë qëllimin e paragrafit të parë të nenit.

Neni 6 Pagesat

6.01 Taksat, tatimet dhe tarifat

Pala Përfituese do të paguajë të gjitha taksat, tatimet dhe tarifat të çdo lloji natyre qofshin, duke përfshirë pullat e taksave dhe tarifën e regjistrimit, që lindin nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve lidhur me të, në përputhje me ligjet vendase të aplikueshme. Në rast të shlyerjes së grantit ose një pjese të saj, në zbatim të nenit 7, të gjitha shumat e pagueshme nga Pala Përfituese për Bankën do të paguhet pa zbritur ndonjë taksë, të çfarëdolloj natyre qoftë.

6.02 Pagesa të tjera

GDWSS do të mbulojë pagesat e tyre profesionale dhe bankare dhe çdo lloj pagese për transfertë apo shkëmbim që shkaktohen nga ekzekutimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe kontratat e konsulencës.

Neni 7 Shkelja e detyrimit

7.01 E drejta për të kërkuar shlyerje

Pala Përfituese do të shlyejë menjëherë grantin, me kërkesë të Bankës, në çdo rrethanë të mëposhtme:

a) Nëse Pala Përfituese ose GDWSS nuk përmbushin detyrimet që u vendosen sipas kësaj Marrëveshjeje brenda një kohe të caktuar në mënyrë të arsyeshme në një njoftim që i jepet nga Banka lidhur me zbatueshmërinë që kërkohet nga Pala Përfituese ose GDWSS;

b) Nëse informacioni që i jepet Bankës nga ose në emër të palës përfituese ose GDWSS-së lidhur me negocimin e kësaj Marrëveshjeje, rezulton se është i pasaktë në çdo material të veçantë;

c) Nëse Banka gjykon se gjatë kryerjes së detyrimeve të tyre, Pala Përfituese ose GDWSS kanë vepruar me neglizhencë të madhe, me mashtrim, me veprime të paligjshme ose kanë shfaqur sjellje të pahijshme të qëllimtë;

d) Nëse Banka pezullon ose anulon një hua ose nëse Banka ka kërkuar shlyerje të një huaje të dhënë nga Banka për Palën Përfituese ose nëse një kontratë financimi e lidhur ndërmjet Bankës dhe palës përfituese është deklaruar e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një gjykatë kompetente e së drejtës;

e) Nëse Pala Përfituese ose GDWSS nuk arrijnë të bëjnë në kohë shlyerjen e ndonjë prej shumave që i detyrohen Bankës, sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër ndryshe nga kjo Marrëveshje;

f) Nëse ndonjë nga faktet e shprehura në deklarata ndryshon ose pushon së ekzistuari dhe nëse interesat e Bankës janë në opinionin e tij të cenuara.

7.02 Të drejta të tjera me ligj

Neni 7.01 nuk do të kufizojë ndonjë të drejtë tjetër të Bankës për të kërkuar shlyerjen e grantit.

Neni 8 Detyrimet e palëve

Pala Përfituese do të zhëdmojë Bankën ndaj të gjitha dëmtimeve, humbjeve, kostove dhe shpenzimeve që lindin ose shkaktohen nga Banka, ndër të tjera, si rezultat i ndonjë veprimi ose mosveprimi nga ajo ose GDWSS, nga mospërmbushja e Palës Përfituese ose e GDWSS-së të ndonjë prej detyrimeve të tyre përkatëse, të përcaktuara në këtë Marrëveshje, që lindin nga neglizhenca e madhe, për ndonjë veprim të paligjshëm, të qëllimshëm ose për ndonjë veprim mashtrimi.

Banka nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës Përfituese ose GDWSS për ndonjë veprim ose mosveprim nga ana e konsulentëve ose për pamundësinë e konsulentëve për të siguruar shërbime konsulence në përputhje me kontratat e shërbimit të konsulencës. Megjithatë, Pala Përfituese ose GDWSS mund t'i kërkojnë Bankës të ndryshojë konsulentët ose ndonjë prej tyre, në rast se efektshmëria e tyre në opinionin e Palës Përfituese ose të GDWSS rezulton të jetë e pakënaqshme, ose nëse konsulentët duhet të kryejnë ndonjë veprim ose mosveprim të padëshiruar.

Banka do të bëjë përpjekjet e saj të arsyeshme për të përmbushur çdo kërkesë nga ana e saj në zbatim të kontratave të konsulencës.

Pala Përfituese nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Bankës, konsulentëve ose ndaj ndonjë pale të tretë për ndonjë veprim ose mosveprim nga ana e konsulentëve, ose pamundësi nga ana e konsulentëve për të siguruar shërbime konsulence në përputhje me kontratat e shërbimit të konsulencës.



Neni 9 Konfidencialiteti

Banka do të trajtojë çdo informacion që i jepet nga Pala Përfituese ose nga GDWSS në zbatim të detyrimeve të këtij të fundit në përputhje me rregullat e saj normale të konfidencialitetit.

Neni 10 Legjislacioni dhe juridiksioni

10.01 Legjislacioni

Kjo Marrëveshje dhe formimi, ndërtimi dhe vlefshmëria e saj do të rregullohen nga ligjet e Luksemburgut.

10.02 Juridiksioni.

Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me këtë Marrëveshje do t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Luksemburgut dhe Palët në këtë Marrëveshje do t'i nënshtrohen në mënyrë të parevokueshme juridiksionit të Gjykatës së Luksemburgut.

Palët në këtë Marrëveshje heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës së Luksemburgut. Vendimi që jepet nga Gjykata e Luksemburgut në zbatim të këtij neni, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët, pa kufizim ose rezerva.

10.03 Mosheqja dorë

Asnjë mospërbushje ose vonesë nga Banka në ushtrimin e ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të interpretohet si heqje dorë nga një e drejtë e tillë.

Neni 11 Klauzolat përfundimtare

11.01 Njoftimet

Njoftimet dhe të gjitha komunikimet e tjera në këtë Marrëveshje (përveç atyre që lindin nga çështjet gjyqësore) për Bankën ose ministrinë do të dërgohen me faks, telegram, letër të regjistruar ose letër ku regjistrohet dorëzimi, adresuar atij në adresën e tij të përcaktuar si më poshtë, ose në ndonjë adresë tjetër, siç do t'i njoftohet paraprakisht Palës tjetër me shkrim mbi adresën e re për këtë qëllim:

Për Bankën:

Banka Europiane e Investimeve
Lending Operations MA-3/Project
Directorate 100,
Luxembourg Konrad Adenauer
L-2950 Luxembourg

Për Ministrinë:

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1
Tirana, Albania
Numër faksi: + 355 4 228 494

Kopje për: Ministrinë e Punëve Publike dhe
Transportit:

Drejtoria e Përgjithshme
e Ujësjetës-Kanalizimeve
(GDWSS)
Faks:

11.02 Deklaratat, grafikët dhe anekset

Deklaratat dhe grafikët formojnë pjesë të kësaj Marrëveshje:

Grafiku A: Përshkrimi teknik

Grafiku B: Kërkesa për disbursim

Në dëshmi të kësaj, Palët në këtë Marrëveshje kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të bëhet në emër të tyre, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Nënshkruar për dhe në emër të
Bankës Europiane të Investimeve
Z. Christopher Hurst
Drejtor i Përgjithshëm

Z. Dominique Courbin
Shef i Divizionit

Nënshkruar për dhe në emër të
Ministrit të Financave të Shqipërisë
Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave

GRAFIKU A
PËRSHKRIMI TEKNIK

Qëllimi i shërbimeve konsulente do të jetë si vijon:

1. Faza 1

a) Asistencë teknike për PIU/NZP, faza 1 (nëntor 2011 - qershor 2013).

b) Studime mbi fizibilitetin e sistemeve të ujësjellës dhe kanalizimeve, në plotësim të studimeve ekzistuese mbi rrjetet e kanalizimeve të Durrësit/Plazhit dhe studim paralel për furnizimin me ujë i financiar nga PHRD (maj 2012 - shtator 2012).

c) Vlerësimi i ndikimit mjedisor (korrik 2012 - shtator 2012).

d) Identifikimi i një programi investimi duke përfshirë veçanërisht: (i) investimet prioritare në sistemet e shpërndarjes së ujit në rajonin e Durrësit dhe në qytetin e Durrësit, duke përfshirë reduktimin e humbjeve; (ii) zgjerimin e rrjeteve dytësore dhe terciare të kanalizimeve, rehabilitimi i sistemeve ekzistuese të kanalizimeve, duke marrë parasysh rritjen e planifikuar të furnizimit me ujë; masat e nevojshme për të shmangur derdhjet e ujit të papërpunuar në qytetin e Durrësit dhe masat prioritare për higjienën në rajonin e Durrësit (shtator 2012 - tetor 2012).

e) Planet për lejet e ndërtimit (tetor 2012 - mars 2013).

2. Në varësi të miratimit paraprak nga Banka, shërbime të tjera konsulence lidhur me përgatitjen e planeve dhe dokumenteve të tenderimit (nëntor 2011 - mars 2013).

Ky përshkrim teknik mund të ripërcaktohet me aprovim të Bankës.

Termet e referencës të shërbimeve të konsulencës do të miratohen nga Banka.

Shuma totale që do të financohet nga WBIF është 950.000 euro.



GRAFIKU B KËRKESA PËR DISBURSIMIN

Faza që vijon me kryerjen e pagesave të mëposhtme:

Data:

Marrëveshje financimi
Emri:

Asistencë teknike për zbatimin e projektit - projekti për sistemin e ujësjellësit të Durrësit në Shqipëri.
Granti për asistencë teknike sipas kuadrit për investime në Ballkanin Perëndimor

Marrëveshje financimi
Data e nënshkrimit

Buxheti i WBIF/EIB
dhe
Buxheti i
WHIF/EWBJF

Numri FI i
Marrëveshjes
(nëse është
e përshtatshme)

Burimi i financimit

Shuma e kërkuar në Euro	
Euro	Shuma

Data e propozuar për
rimbursimin

Rezervuar për EIB	Buxheti i WBIF/EIB	Buxheti WBIF/EWBJF
	Euro	Euro
Shuma totale e grantit	475.000	475.000
Data e kryerjes së pagesës		
Bilanci për shlyerjen		
Pagesa aktuale		
Bilanci pas kryerjes së pagesës		

Llogaria bankare e palës përfituese për kryerjen e kreditimit:

Nr. i llogarisë:

(lutemi shënoni formatin IBAN)

Kodi BIC:.....

Emri dhe adresa e Bankës.....

Lutemi dërgoni informacionin përkatës tek:

Emri (emrat) dhe nënshkrimin (nënshkrimet) e autorizuar të palës përfituese

VENDIM

Nr. 465, datë 18.7.2012

PËR INTEGRIMIN GJINOR NË PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 2 e 13, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në kërkesat buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015, brenda një ose dy programeve buxhetore, të përcaktojnë minimalisht një objektivi të politikës gjinore për të zbatuar integrimin gjinor në buxhetim.

2. Duke filluar nga viti 2013, të përfshihen në procesin e buxhetimit gjinor të gjitha ministrinë e linjës.

3. Ministrinë të përcaktojnë tregues të përshtatshëm dhe të matshëm gjinorë për objektivat dhe produktet e secilit program, për të cilin do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim.

4. Grantet që do të alokohen nga fondi për zhvillimin e rajoneve të marrin në konsideratë kritere që ndikojnë pozitivisht në barazinë gjinore.

5. Përcaktimi i programeve buxhetore, për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim, të bëhet mbështetur në objektivat e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, 2011-2015.

6. Ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të këshillojë të gjitha ministrinë për të përcaktuar programet buxhetore për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor.

7. Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e procedurave më të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ngarkohen të gjitha ministrinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 467, datë 18.7.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LAÇ TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Laç të qarkut të Lezhës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 207 (dyqind e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1454 (një mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Laç për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Laç

Lidhja nr. 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-27	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
28-35	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
42, 55, 56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
65-97	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
142-173,184,185,192-193,197-315,357-510,536-551,555,557-560,564-566	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
174-183,186-191,194-196,316-356,748-807,883-910,912-973,975-1038,1042-1062,1064-1094,1096-1149,1151-1205,1267-1357	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
511-513	Varrezat publike	Në pronësi
514	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
1363-1366	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1367,1368,1450,1454	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
1428-1434	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve	Në pronësi
515,516,552,553,554,556,563,579-581,679,680,686-747	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

VENDIM

Nr. 470, datë 18.7.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË PORTIT TË JAHEVE NË
QYTETIN E DURRËSIT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SUBJEKTIT “I.S.D.C.”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës BOT (ndërtim-shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit), të ndërtimit dhe shfrytëzimit të portit të jahteve në qytetin e Durrësit është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Miratimin e bonusit prej 7% të pikëve për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet subjektit “I.S.D.C.”.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM

Nr. 472, datë 18.7.2012

**PËR SHPALLJEN “PARK KOMBËTAR” TË EKOSISTEMIT NATYROR MALI I
TOMORIT, ME SIPËRFAQE TË ZGJERUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 1 shkronja “b”, 6 e 13 të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror mali i Tomorit, me sipërfaqe të zgjeruar, sipas përcaktimeve në hartën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e këtij Parku Kombëtar janë, si më poshtë vijon:

a) Veri:

Pika 1, kuota 804.0 m, me koordinata 44255630.30 L/4514853.20 V, vijon me kurrizin sipër ujëmbledhësit të Dardhës, kuotat 828.0 m, 781.0 m, 766.0 m e 645.0 m, zbrer kurrizin, kuota 320.0 m, ndjek rrjedhën e përroit të Leshnicës, në drejtim të Lindjes, deri te pika 2, kuota 262.8 m, me koordinata 4433012.69 L/4516042.90 V.

b) Lindje:

Pika 2, kuota 262,8 m, me koordinata 4433012.69 L/4516042.90 V, vijon në krahun e majtë të rrjedhës së lumit të Tomoricës, në drejtim të jugut, kuota 377.0 m, vijon përsëri me krahun e majtë të rrjedhës së lumit të Tomoricës deri te pika 3, me koordinata 4440357.62 L/4496629.90 V.

c) Jug:



Pika 3, me koordinata 4440357.62 L/4496629.90 V, ndjek përroin dhe kurrizin në drejtim të perëndimit, kuota 11543.0 m, ndërpret rrugën auto dhe i ngjitet kurrizit, kalon në kuotat 2115.0 m (mali i Zaloshnjës) e 1855.0 m, zbret kurrizin, kalon në krahun lindor të faqes së Murgovës dhe ndjek kuotat 1533.0, 1331.0 m, 1252.0 m (pranë livadheve të Mollasit), 1217.0 m (m.Varri i Janit) e 1138.0 m, kalon në Qafën e Lajthisë, kuotat 885.0 m (bregu i Tegurit), 887.0 m e 796.0 m, pranë fshatit Selani, deri te pika 4, kuota 722,0 m, me koordinata 4429078.51 L/4492547.29 V.

ç) Perëndim:

Pika 4, kuota 722.0 m, me koordinata 4429078.51 L/4492547.29 V, zbret kurrizin e ndërpret përroin e Bogovës në kuotën 233.0 m dhe i ngjitet kurrizit, duke ndjekur vijën ndarëse të zonës së mbrojtur të burimeve ujore të Bogovës me veprimtaritë e nxjerrjes së pllakave të gurit dekorativ, me kuotën 1832.0 m, vijon përgjatë kurrizit (pranë shtegut të Jaupit), më pas ndjek rrugën auto, vijon në drejtim të kuotës 721.0 m (fusha e Çeços), kuota 605.0 m, ndërpret përroin, i ngjitet kurrizit dhe vijon me kuotat 543.0 m e 656.0 m, zbret kurrizin dhe ndërpret rrugën auto dhe përroin e Kapinovës në kuotën 280.0 m, i ngjitet kurrizit dhe vijon me kuotat 856.0 m 682.4 m e 625.0 m, ndërpret përroin e Lybeshës në kuotën 293.0 m, i ngjitet kurrizit poshtë fshatit Lybeshë, kuota 717.0 m, ndërpret lumin e Tomorit, vijon përgjatë kurrizit me kuotën 818.0 m, ndërpret Përroin e Gropës, në kuotën 325.0 m, ndjek degën e përroit të Gropës, në drejtim të veriut, kuota 648.0 m, zbret kurrizin dhe vijon përgjatë përroit të Bejasit, kuota 476.0 m, më pas me kuotën 1 018.0 m, ndjek rrugën auto dhe kuotat 1 021.0 m, 868.0 m e 780.0 m, ndjek rrugën pranë fshatit Perisnakë, kalon në pikën e takimit të përroit të Indraxhit me përroin Qendere dhe ndjek përroin e Kanatikut në fshatin Dardhë, i ngjitet kurrizit, kuota 811.0 m, vijon përgjatë kurrizit sipër ujëmbledhësit, kuota 835.0 m deri te pika 1, kuota 804.0 m, me koordinata 44255630.30 L/4514853.20 V.

3. Parku Kombëtar Mali i Tomorit ka sipërfaqe të përgjithshme 24 723.1 (njëzet e katër mijë e shtatëqind e njëzet e tre pikë një) ha:

a) në qarkun e Beratit 23 444.2 (njëzet e tre mijë e katërqind e dyzet e katër pikë dy) ha. Nga të cilat rrethi i Beratit 8 398.4 (tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë katër) ha dhe rrethi i Skraparit 15 045.8 (pesëmbëdhjetë mijë e dyzet e pesë pikë tetë) ha;

b) në qarkun e Elbasanit 1 278.9 (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë pikë nëntë) ha, në rrethin e Gramshit.

Pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet me pyje dhe kullota, të ndjekura nga sipërfaqet bujqësore, joproduuese dhe ato urbane e troje të përziera me tokë, bujqësore e pyjore, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Parku Kombëtar Mali i Tomorit ndahet në 4 nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Nënzona qendrore, e shënuar në hartë me ZQ, me sipërfaqe 7 484.4 (shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër pikë katër) ha:

i) në qarkun e Beratit 7 251.6 (shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një pikë gjashtë) ha, nga të cilat rrethi i Beratit 3 088.1 (tre mijë e tetëdhjetë e tetë pikë një) ha dhe rrethi i Skraparit 4 163.5 (katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesë) ha;

ii) në qarkun e Elbasanit 232 (dyqind e tridhjetë e dy pikë tetë) ha, në rrethin e Gramshit.

Kjo nënzona përfshin habitatet kryesore pyjore dhe basenin ujëmbledhës të burimeve të ujit të pijshëm të Bogovës. Përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe në të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë, si dhe kullotja sezonale.

b) Nënzona e përdorimit tradicional, e shënuar në hartë me ZPT, me sipërfaqe 15 640.9 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet pikë nëntë) ha:

i) në qarkun e Beratit 14 717.6 (katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë pikë

gjashtë) ha, nga të cilat rrethi i Beratit 4 658.2 (katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë dy) ha dhe rrethi i Skraparit 10 059.4 (dhjetë mijë e pesëdhjetë e nëntë pikë katër) ha;

ii) në qarkun e Elbasanit 923.3 (nëntëqind e njëzet e tre pikë tre) ha, në rrethin e Gramshit.

Kjo nënzonë përfshin tërësisht tokat bujqësore, pjesë të pyjeve e kullotave, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale: bujqësi, pemëtari, pyje, kullotje, grumbullimi i bimëve mjekësore e aromatike dhe të agrobiznesit të qëndrueshëm me përdorim të balancuar të tyre e të peizazhit. Në këtë zonë nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit. Në nënzonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale të agrobiznesit, ato argëtuese, sportive e ekoturistike dhe ndërtimi i infrastrukturës bëhet sipas planeve të zhvillimit, urban e turistik, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

c) Nënzona e zhvillimit të qëndrueshëm, e shënuar në hartë me ZZHQ, me sipërfaqe 1 365.5 (një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë pesë) ha:

i) në qarkun e Beratit 1 242.7 (një mijë e dyqind e dyzet e dy pikë shtatë) ha, nga të cilat rrethi i Beratit 652.1 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy pikë një) ha dhe rrethi i Skraparit 590.6 (pesëqind e nëntëdhjetë pikë gjashtë) ha;

ii) në qarkun e Elbasanit 122.8 (njëqind e njëzet e dy pikë tetë) ha, në rrethin e Gramshit.

Kjo nënzonë përfshin territoret urbane, trojet e përziera me tokë bujqësore, pyjore e kullosore, pranë qendrave të banuara, sipërfaqet e eroduara dhe shtretërit përgjatë lumenjve e përrenjve. Nënzona mundëson vazhdimin e veprimtarive ekonomike, sociale, të ekoturizmit, të agrobiznesit të qëndrueshëm dhe përdorim të balancuar të peizazhit e të burimeve natyrore, shtimin e drurëve të arrorëve, lajthive, vreshtave, pjergullave e të bimëve mjekësore e aromatike, si dhe rehabilitimin e habitateve të dëmtuara. Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, si dhe lejohen veprimtari, të cilat ushtrohen vetëm me leje mjedisore, dhe ndërtimi i infrastrukturës, të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe që nuk bien ndesh me programet e zhvillimit të turizmit e mjedisit për qarkun, me planet vendore dhe të integruara të zonave, të miratuara sipas ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, me planet e menaxhimit të pyjeve e kullotave komunale.

ç) Nënzona e rekreacionit, e shënuar në hartë me ZR, me sipërfaqe 232.3 (dyqind e tridhjetë e dy pikë tre) ha, përfshihet në qarkun e Beratit, rrethi i Skraparit, përgjithësisht, territoret në qafën e Kulmakut. Në këtë nënzonë zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe lejohen veprimtari sociale, të ekoturizmit, të pelegrinazhit dhe ndërtimi i infrastrukturës, të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës, njësitë e qeverisjes vendore, institucionet kërkimore-shkencore, organizatat jofitimprurëse, përfaqësuesit e biznesit dhe pronarët privatë, merr masa për të hartuar planin e integruar të menaxhimit të Parkut Kombëtar Mali i Tomorit, në përputhje me objektivat e menaxhimit të rrjetit ekologjik të vendit, programet e zhvillimit, rajonal e vendor, dhe planet e menaxhimit të pyjeve komunale.

6. Për veprimtaritë turistike zbatohen kriteret dhe standardet e përcaktuara në ligjin nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

Për rastet e trashëgimisë kulturore, veprimtaritë mundësohen me leje të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9806, datë 17.9.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike”. Përvetësimi i objekteve me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.



7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministritë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore të rishikojnë lejet që kanë dhënë për veprimtari ekonomike e shoqërore, brenda sipërfaqes së Parkut Kombëtar. Subjektet e pajisura me lejet përkatëse do të vazhdojnë të ushtrojnë këtë veprimtari nëse nga pikëpamja ligjore përmbushin kriteret e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, si dhe kur janë në përputhje me synimet dhe objektivat e menaxhimit të parkut.

8. Autoriteti shtetëror, që ngarkohet me administrimin e zonës së mbrojtur, janë strukturat e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Administratat ekzistuese të sektorëve pyjorë, sipas përkatësisë në qarqet Berat e Elbasan, që përfshihen brenda sipërfaqes së Parkut Kombëtar, do të kryejnë funksionet e administratës së Parkut Kombëtar Mali i Tomorit, sipas ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

9. Ngarkohen, sipas përkatësisë, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela

Sasia e sipërfaqeve sipas përbërjes

Përdorimi i territorit		Sipërfaqja ha					Totali
		Qarku Berat			Qarku Elbasan		
		Berat	Skrapar	Gjithsej	Gramsh	Gjithsej	
1	Sipërfaqe pyjore, shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore	3,799.4	6,215.5	10,014.9	744.0	744.0	10,758.9
2	Sipërfaqe kullimore e livadhe	1,356.1	6,101.0	7,457.1	21.5	21.5	7,478.6
3	Sipërfaqe bujqësore (arë, pemëtore, vreshta)	2,496.3	2,014.2	4,510.5	168.0	168.0	4,678.5
4	Sipërfaqe joproduhese (shkëmbore, zhavorrishte e zhveshur)	485.7	564.2	1,049.9	329.9	329.9	1,379.8
5	Sipërfaqe ujore (ujëmbledhëse)	20.1	0.0	20.1	0.0	0.0	20.1
6	Sipërfaqe urbane dhe troje të përzier me tokë bujqësore, pyjore e kullimore	240.8	150.9	391.7	15.5	15.5	407.2
	SIPËRFAQE E PËRGJITHSHME	8,398.4	15,045.8	23,444.2	1,278.9	1,278.9	24,723.1



Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 29.8.2012
Doli nga shtypi më 30.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 28 lekë